



MEDPAK

Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara

Adresa: Rruga "Sh. Ishmi", Pallati 38 Shkalla 1 Apt 2, Tiranë

Tel: ++355 4 2345 028 / Cel: 0693577247 E-mail: info@medpak.org / www.medpak.org

Shoqata "MEDPAK" (Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara) kërkon Vullnetarë:

"Mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara" (MEDPAK) është organizatë jo fitimprurëse, që mbron të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, me qendër në Tiranë dhe me degë në disa qarqe te vendit. MEDPAK punon me programe në partneritet dhe të mbështetura kryesisht nga donatorë të huaj dhe vendas si dhe në partneritet me institucionet që punojnë për realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Në kudër të projektit "Arsimi gjithëpërfshirës në Shqipëri për fëmijët me nevoja të veçanta në edukim , projekt i cili po zbatohet në partneritet me "Save the Children" dhe i mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë, **shoqata MEDPAK kërkon vullnetarë në qytetet Peshkopi, Burrel, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë dhe Vlorë.**

Kriteret që kërkohen për vullnetarët :

- Të ketë mbaruar ose te jete ne vazhdim të shkollës së lartë në degët: punë sociale, mësuesi, psikologji dhe ne studimet master të shkencave sociale ose te edukimit.
- Të ketë aftësi komunikimi të mira me fëmijët dhe të jetë kreativë kur punon me ta .
- Të njohë të drejtat e fëmijëve dhe të punojë për zbatimin e tyre nga çdo individ dhe institucion.
- Të ketë aftësi komunikuese të mira dhe të bashkëpunojë me stafin e shkollave dhe kopshteve ku po zbatohet projekti.
- Të jetë korrekt dhe të respektojë kodin e etikës së shoqatës dhe protokollin e punës me fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Të ketë vullnet dhe dëshirë për të rritur kapacitetet e veta profesionale ne fushën e aftësisë së kufizuar, pasi gjatë punës së tij si vullnetar do ti ofrohen trajnime në fushën e arsimit gjithëpërfshirës.

Përgjegjësitë:

Vullnetarët do të jenë në varësi direkt të koordinatores lokale të projektit. Do të asistojnë mbarëvajtjen e aktiviteteve të projektit.

Vullnetarët në disa raste do të asistojnë mësuesit që punojnë në klasa ku ka fëmijë me aftësi të kufizuara e vështirësi në të nxënë.

Personi që dëshiron të aplikojë si vullnetar të dërgojë : një letër interesi dhe CV, duke shprehur qartë se përse mendon se mund të jetë i përshtatshëm për të punuar vullnetarisht në shoqatën MEDPAK si dhe kohën që mund të punojë (sa orë në javë/muaj) në adresën: info@medpak.org